

20151935324

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KOMUNIKIME
ELEKTRONIKE

Neni 1

Në Ligjin për komunikime elektronike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 39/14, 188/14 dhe 44/15), në nenin 127 në paragrafin (2) pas fjalëve: “Unioni Ndërkombëtar për Telekomunikime” shtohen fjalët “ose nëse është caktuar me ligj të veçantë”.

Neni 2

Në nenin 180 paragrafi (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 7% deri 10% të të hyrave të përgjithshme vjetore të personit juridik, përkatësisht tregtarit individ (paraqitur në shumë absolute) të realizuara në vitin afarist që i paraprin vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të hyrat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtër se një vit që i paraprin kundërvajtjes, nëse në atë vit personi juridik, përkatësisht tregtari-individ ka filluar të punojë, do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse:”.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik përkatësisht tregtarin individ do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 3

Në nenin 181 paragrafi (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 4% deri 7% të të hyrave të përgjithshme vjetore të personit juridik, përkatësisht tregtarit individ (paraqitur në shumë absolute) të realizuara në vitin afarist që i paraprin vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të hyrat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtër se një vit që i paraprin kundërvajtjes, nëse në atë vit personi juridik, përkatësisht tregtari-individ ka filluar të punojë, do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse:

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik përkatësisht tregtarin individ do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 4

Në nenin 182 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse pas fjalëve: “personit juridik” shtohen fjalët: “përkatësisht tregtarit individ”.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik përkatësisht tregtarin individ do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 5

Në nenin 183 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse pas fjalëve: “personit juridik” shtohen fjalët: “përkatësisht tregtarit individ”.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik përkatësisht tregtarin individ do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 6

Në nenin 184 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse pas fjalëve: “të hyra vjetore të personit juridik” shtohen fjalët: “përkatësisht tregtarit individ”.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik përkatësisht tregtarin individ do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 7

Pas nenit 186 shtohet nen i ri 186-a si vijon:

“Neni 186-a

Llogaritja e lartësisë së gjobës për personin juridik, përkatësisht për tregtarin individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.”

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.